



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE  
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

# Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare<sup>1</sup> (Janar-Prill, 2020)

---

<sup>1</sup> Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

---

Tel+(355) 4 2222411  
+(355) 4 2233356  
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,  
Tiranë, Shqipëri

[info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

## **Tabela e Përmbajtjes**

Hyrje .....	3
Fusha statistikore 1: Statistikat demografike dhe sociale .....	5
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike .....	11
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale .....	18
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain .....	33



## Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësisimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4- mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Janar – Prill 2020, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet edhe projekt-Planit Vjetor 2020 për zbatimin e PSZ-së, i dërguar për miratuar me vendim të veçantë të Kuvendit, i cili përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të katër fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi dhe publikimi dhe transmetimi i të dhënave. Gjithashtu për çdo aktivitet përcaktohet niveli i të dhënave si dhe përrouthshmëria me Eurostat. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë dhe aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore si dhe aktivitetet e përealizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raportet 4 - mujore për ecurinë e Planit Vjetor për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave, dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.



## PROGRES-RAPORTI Janar-Prill, 2020

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2020 INSTAT së bashku me dy agjencitë statistikore përgjegjëse, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për realizimin e aktivitetëve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe në zbatim të planit 2020 të PSZ-së.

Në funksion të përmirësimit të matjes së performancës, ky raport, në ndryshim nga raportet e kaluara, paraqet një nivel më të lartë detajimi si në fazat e prodhimit statistikor ashtu edhe në elementët kategorizues të tyre.

Elementët shtesë të raportimit janë si më poshtë:

- Për fazën e grumbullimit të të dhënave është shtuar si kategori burimi dhe niveli i të dhënave;
- Për fazën e publikimit është shtuar si kategori niveli i publikimit të të dhënave (vend, rajon, qark, bashki);
- Është shtuar faza e transmetimit të të dhënave në Eurostat, e detajuar në 3 kategori që lidhen me detyrimin për transmetim të dhënash, situatën aktuale dhe përmirësimin në transmetim;
- Është shtuar dhe niveli i përputhshmërisë së aktivitetëve me Eurostat (i pavlerësuar, i papërputhshëm, i ulët, i mesëm, i lartë, plotësisht i përputhshëm).

### Informacion përmbledhës:

Sipas planit vjetor të PSZ janë parashikuar 82 aktivitete statistikore në total për periudhën 4-mujore. Gjatë zbatimit të aktivitetëve janë realizuar 129 produkte statistikore, të cilat janë ndarë përkatësisht sipas agjencive si më poshtë:

- INSTAT: 73 aktivitete statistikore - 114 produkte statistikore;
- Banka e Shqipërisë: 7 aktivitete statistikore - 13 produkte statistikore;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë: 2 aktivitete statistikore - 2 produkte statistikore si statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë dhe statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar.

*Numri i produkteve statistikore sipas fazave të prodhimit:*

- Grumbullimi i të dhënave:
  - Grumbulluar të dhënat në kohë për 109 produkte statistikore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

41 vrojtme: 16 PAPI; 3 CAPI; 22 Kombinuar  
48 burime administrative: 8 mikro; 38 makro; 9 kombinuar  
19 burime të kombinuara: 9 makro; 10 kombinuar  
-Nuk janë grumbulluar në kohë të dhënat për 8 produkte statistikore

- Përpunimi i të dhënave:  
-Përpunuar të dhënat në kohë për 106 produkte statistikore  
-Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 5 produkte statistikore
- Publikimi i të dhënave  
-Publikuar të dhënat në kohë për 63 produkte statistikore  
-Nuk janë publikuar të dhënat në kohë për 3 produkte statistikore
- Transmetimi i të dhënave në Eurostat  
-Duhet transmetuar të dhënat për 45 produkte statistikore  
-Janë transmetuar të dhënat për 41 produkte statistikore  
-Përmirësim në cilësinë e transmetimit për 3 produkte statistikore

*Aktivitetet statistikore të ndikuara nga situata Covid-19:*

1. Regjistrimet në arsimin universitar
2. ABF 2020
3. SILC 2020
4. Vrojtimi tremujor për çmimet në ndërmarrje
5. Statistikat mbi lejet e ndërtimit
6. Vrojtimi Vjetor në Bujqësi 2019
7. Anketa e Strukturave Akomoduese
8. Anketa e Turizmit në familje
9. Vrojtimi vjetor i TIK në ndërmarrje

Të dhënat e detajuara gjenden të përshkruara sipas fushave statistikore.

## **Fusha statistikore 1: Statistikat demografike dhe sociale**

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikat e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimin, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikore të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqenies



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Për këtë fushë statistikore, janë 19 aktivitete që kanë produkt në këtë katërmujor dhe këto aktivitete konvertohen në 26 produkte statistikore.

## 1. Grumbullimi i të dhënave:

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 20 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për 19 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Statistikat e popullsisë
  - ✓ Migracioni ndërkombëtar
  - ✓ Statistikat vitale për T 4, 2019
  - ✓ Statistikat vitale për T 1, 2020
  - ✓ Statistikat gjinore
  - ✓ Anketa tremujore e forcave të punës për T 4, 2019
  - ✓ Anketa tremujore e forcave të punës për T 1, 2020
  - ✓ Të dhënat administrative të tregut të punës për T 4, 2019
  - ✓ Të dhënat administrative të tregut të punës për T 1, 2020
  - ✓ Të dhëna administrative mbi pagat për T 4, 2019
  - ✓ Të dhëna administrative mbi pagat për T 1, 2020
  - ✓ Statistika të diplomimeve në arsimin e lartë
  - ✓ Shpenzimet e buxhetit të shtetit mbi arsimin publik
  - ✓ Shkaqet e vdekjeve
  - ✓ Anketa e buxhetit të familjes 2019
  - ✓ Të dhëna administrative të mbrojtjes sociale për T4, 2019
  - ✓ Tregues mbi: Vepra penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur
  - ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T4, 2019
  - ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T1, 2020
- Për 5 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojttimeve, ku në 3 vrojttime është përdorur metoda CAPI dhe në 2 të tjera është përdorur metoda PAPI.
- Për 12 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative, ku për 5 nga këto burime të dhënat janë mikro dhe për 7 të tjerat të dhënat janë makro.
- Për 2 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar nga burim i kombinuar, ku të dhënat për 1 produkt janë makro dhe për tjetrin të kombinuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

➤ **Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për produktin e mëposhtëm:**


- Statistika të regjistrimeve në arsim për arsimin universitar

**Arsyeja e mozbatimit të afatit:** Të dhënat janë grumbulluar pjesërisht, sepse ende pritet dërgimi i të dhënave të regjistrimeve të arsimit të lartë nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të cilat do të përfshihen në publikimin “Shqipëria në Shifra”. Vonesa është shkaktuar për shkak të situatës së Covid 19.

**Informacion shtesë:**

-Anketa e Buxhetit të Familjes 2020: Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 është ndërprerë mbledhja në terren e të dhënave për muajt Mars dhe Prill, 2020. Afati përfundimtar për grumbullimin e të dhënave është V+7 ditë, data 7 Janar, 2021.

-Anketa e Nivelit të jetesës 2020: Për shkak të situatës së krijuar COVID-19 është shtyrë për në Korrik, por që të dhënat do të grumbullohen brenda afatit V+205 D, brenda datës 25 Korrik, 2020.



1. Grafiku përmbledhës i fazës së grumbullimit për fushën 1. Statistikat Sociale dhe demografike

**2. Përpunimi i të dhënave**

- **Planifikuar për tu përpunuar të dhënat për 19 produkte statistikore**
- **Të dhënat janë përpunuar në kohë për 17 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Statistikat e popullsisë




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Migracioni ndërkombëtar
- ✓ Statistikat Vitale për T4, 2019
- ✓ Statistikat Vitale për T1, 2020
- ✓ Statistikat gjinore
- ✓ Anketa tremujore e forcave të punës për T 4, 2019
- ✓ Të dhënat administrative të tregut të punës për T 4, 2019
- ✓ Të dhëna administrative mbi pagat për T 4, 2019
- ✓ Statistika të diplomimeve në arsimin e lartë
- ✓ Shpenzimet e buxhetit të shtetit mbi arsimin publik
- ✓ Shkaqet e vdekjeve
- ✓ Anketa e buxhetit të familjes 2019
- ✓ Anketa e Nivelit të Jetesës 2019
- ✓ Të dhëna administrative të mbrojtjes sociale për T4, 2019
- ✓ Tregues mbi: Vepra penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur
- ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T4, 2019
- ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T1, 2020

➤ **Të dhënat nuk janë përpunuar në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**

- Statistika të regjistrimeve në arsimin parauniversitar dhe universitar

**Arsyeja e mozbatimit të afatit:** Për shkak të grumbullimit me vonesë (siç është përmendur në fazën e grumbullimit) të dhënat nuk u përpunuan në kohë.



2. Grafiku përmbledhës i fazës së përpunimit për fushën 1. Statistikat Sociale dhe demografike





### 3. Publikimi i të dhënave

➤ **Planifikuar publikimi i të dhënave për 11 produkte statistikore**

➤ **Publikuar të dhënat në kohë për 9 produktet e mëposhtme:**

- ✓ Statistikat vitale për T4, 2019
- ✓ Anketa tremujore e forcave të punës për T4, 2019
- ✓ Të dhënat administrative të tregut të punës për T4, 2019
- ✓ Të dhëna administrative mbi pagat për T4, 2019
- ✓ Të dhëna administrative të mbrojtjes sociale për T4, 2019
- ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T4, 2019
- ✓ Tregues për të dhënat e kulturës për T1, 2020
- ✓ Shkaqet e vdekjeve
- ✓ Tregues mbi: Vepra penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur

- Për 11 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel vendi
- Për 1 aktivitet statistikor të dhënat janë në nivel rajoni
- Për 5 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel qarku
- Për 1 aktivitet statistikor të dhënat janë në nivel bashkie

➤ **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**

- Statistikat e popullsisë


**Arsyeja e moszbatimit të afatit:** Publikimi i statistikave të popullsisë u shty me 43 ditë, ishte planifikuar të publikoheshin me 11 Shkurt, 2020 dhe u publikuan me 26 Mars, 2020. Shtyrja e publikimit është bërë me vendim të brendshëm.

- Migracioni ndërkombëtar

**Arsyeja e moszbatimit të afatit:** Publikimi i statistikave të migracionit ndërkombëtar u shty me 43 ditë, ishte planifikuar të publikoheshin me 11 Shkurt, 2020 dhe u publikuan me 26 Mars, 2020. Shtyrja e publikimit është bërë me vendim të brendshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE



3. Grafiku përmbledhës i fazës së publikimit për fushën 1. Statistikat Sociale dhe demografike

#### 4. Transmetimi i të dhënave

- Duhet transmetuar të dhënat për 5 produkte statistikore
- Janë transmetuar të dhënat për 2 produkte statistikore si më poshtë:
  1. Statistika të diplomimeve në arsimin parauniversitar
  2. Statistika të diplomimeve në arsimin universitar


- Përmirësim në transmetim:  
Nuk ka

- **Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat kemi:**

- 2 aktivitete për të cilat nuk është vlerësuar niveli i përputhshmërisë
- 2 aktivitete me nivel të papërputhshëm me Eurostat
- 2 aktivitete me nivel të ulët përputhshmërie
- 8 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie
- 1 Aktivitet me nivel të lartë përputhshmërie
- 2 Aktivitete në përputhshmëri të plotë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE



4. Grafiku përmbledhës i fazës së transmetimit për fushën 1. Statistikat Sociale dhe demografike

## Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

**Agjencitë statistikore përgjegjëse:** INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Për këtë fushë statistikore, janë 17 aktivitete që kanë produkt në këtë katërmujor dhe këto aktivitete konvertohen në 26 produkte statistikore për të cilat:

- INSTAT është përgjegjës për 12 aktivitete-15 produkte statistikore
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 3 aktivitete - 9 produkte statistikore
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për 2 aktivitete - 2 produkte statistikore



## 1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 25 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për 23 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB-së tremujore me metodën e prodhimit, me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe të përshtatura sezonalisht për T4, 2019
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht për T4, 2019
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M12, 2019
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M1, 2020
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M2, 2020
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M3, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M12, 2019
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M1, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M2, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M3, 2020
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare për T4, 2019
  - ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
  - ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar për T4, 2019
  - ✓ Vrojtimi vjetor për listën e produkteve industriale pranë ndërmarrjeve ekonomike
  - ✓ Vrojtimi tremujor për statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për T4, 2019
  - ✓ Vrojtimi tremujor për statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike për T4, 2019
  - ✓ Vrojtimi tremujor për statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike për T1, 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë për T4, 2019
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë për T1, 2020
- ✓ Regjistri njësive ekonomike
- ✓ Përditësimi në kohë reale i regjistrit statistikor të ndërmarrjeve duke ndërtuar “Live Register”

-Për 3 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimeve, në të cilat është përdorur metoda PAPI

-Për 8 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative, ku për 1 burim të dhënat janë makro, për 1 të dhënat janë mikro dhe për 6 burime të tjera të dhënat janë të kombinuara.

-Për 9 produkte të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara me të dhëna të kombinuara.

➤ **Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**

- Vrojtimi tremujor për statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike për T1 2020.


**Arsyeja e moszbatimit të afatit:** Afati për grumbullimin e të dhënave ishte T+20 D, data 20 Prill, 2020, por për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 kemi një vonesë prej dy javësh në daljen në terren, gjë e cila solli vonesë në grumbullimin e të dhënave.

- Lejet e ndërtimit për T1, 2020

**Arsyeja e moszbatimit të afatit:** Afati për grumbullimin e të dhënave ishte T+30 D, data 30 Prill, 2020, por për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 kemi një vonesë, është burim administrativ i grumbulluar nga Zyrat rajonale pranë bashkive gjë e cila solli vonesë në grumbullimin e të dhënave.



## 2. Statistikat ekonomike



1. Grafiku përmbledhës i fazës së grumbullimit për fushën 2. Statistikat ekonomike


## 2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar për të përpunuar të dhënat për 22 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për 22 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB-së tremujore me metodën e prodhimit, me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe të përshtatura sezonalisht për T4, 2019
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht për T4, 2019
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M12, 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M1, 2020
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M2, 2020
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M3, 2020
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M12, 2019
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M1, 2020
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M2, 2020
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M3, 2020
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare për T4, 2019
- ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
- ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar për T4, 2019
- ✓ Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve
- ✓ Statistikave strukturore në nivel rajonal
- ✓ Vrojtimi vjetor për listën e produkteve industriale pranë ndërmarrjeve ekonomike
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për T4, 2019
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike për T4, 2019
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë për T4, 2019
- ✓ Regjistri i njësive ekonomike



2. Grafiku përmbledhës i fazës së përpunimit për fushën 2. Statistikat ekonomike

### 3. Publikimi i të dhënave


- **Planifikuar për tu publikuar të dhënat për 20 produkte statistikore**
- **Publikuar të dhënat në kohë për 19 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit
  - ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB-së tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht për T4, 2019
  - ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht për T4, 2019.
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M12, 2019
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M1, 2020
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M2, 2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë për M3, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M12, 2019
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M1, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M2, 2020
  - ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje për M3, 2020
  - ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare
  - ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
  - ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar
  - ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për T4, 2019
  - ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike T4 2019.
  - ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë T4, 2019
  - ✓ Statistikat strukturore të ndërmarrjeve
- Për 14 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel vendi
  - Për 2 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel rajoni
  - Për 3 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel qarku





3. Grafiku përmbledhës i fazës së publikimit për fushën 2. Statistikat ekonomike

#### 4. Transmetimi

➤ **Duhet transmetuar të dhënat për 7 produkte statistikore**

➤ **Janë transmetuar të dhënat për 7 produktet statistikore si më poshtë:**

- ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit
- ✓ Llogaritë kombëtare vjetore - Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve
- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB-së tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht për T4, 2019
- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht për T4, 2019.
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për T4, 2019
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të çmimeve në ndërmarrjet ekonomike T4 2019.
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë T4, 2019


- Përmirësim në transmetim për vrojtimin tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për T4, 2019

➤ **Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat kemi:**

- 1 Aktivitet i pavlerësuar
- 2 aktivitete me nivel të ulët përputhshmërie
- 14 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie
- 1 Aktivitet me nivel të lartë përputhshmërie
- 3 Aktivitete në përputhshmëri të plotë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE



4. Grafiku përmbledhës i fazës së transmetimit për fushën 2. Statistikat ekonomike

### Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikore të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Për këtë fushë statistikore janë 45 aktivitete që kanë produkt në këtë katërmujor dhe këto aktivitete konvertohen në 76 produkte statistikore për të cilat:

INSTAT është përgjegjës për 41 aktivitete - 72 produkte statistikore

Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 4 aktivitete - 4 produkte statistikore



## 1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 72 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për 67 produktet e mëposhtme:**
  - ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikat e produkteve bimore
  - ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta për M12, 2019
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta për M1, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta për M2, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta për M3, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve për M12, 2019
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve për M1, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve për M2, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve për M3, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve për M12, 2019
  - ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve për M1, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve për M2, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve për M3, 2020
  - ✓ Vrojtimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht
  - ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopes për M12, 2019
  - ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopes për M1, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopes për M2, 2020
  - ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopes për M3, 2020
  - ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative vjetore për statistikat e llogarive ekonomike në bujqësi
